# Plani për bashkësi të sigurta i Komunës së Istogut për vitin 2009

## 1

***Titulli:***
**Dhuna në familje – një shqetësim për shoqërinë**

Qëllimi:
Qëllimi i këtij projekti është të ngrisë vetëdijen e shoqërisë mbi pasojat e dhunës në familje dhe të fuqizuar bashkëpunim në mes të akterëve përkatës për të parandaluar dhunën në familje dhe për të kontribuar në ruajtjen e institucionit të "familjes së shëndoshë".

Objektivat:
- ✓ Zvogëlimi i rasteve të dhunës në familje;
- ✓ Informimi i qytetarëve për fushat më të ndikuara nga dhuna në familje;
- ✓ Fuqizimi i Qendrave për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje

## 2

***Titulli:***
**Parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore dhe i prostitucionit**

Qëllimi:
Fuqizimi i bashkëpunimit në mes të akterëve institucional dhe bashkësisë në aspektin e reintegrimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe prostitucionit dhe ngritja e vetëdijesimit të shoqërisë për rolin e saj në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe prostitucionit.

Objektivat:
- ✓ Mbështetja përmes programeve psiko-sociale dhe trajnimeve për personat e prekur nga trafikimi me qenie njerëzore dhe prostitucionit
- ✓ Zvogëlimi i parakushteve / rrethanave të cilat shpijnë drejt trafikimit me qenie njerëzore dhe prostitucionit
- ✓ Informimi dhe ngritja e vetëdijesimit lidhur me gjendjen aktuale.

## 3

***Titulli:***
**Siguria në shkollë**

Qëllimi:
Shtimi i nivelit të sigurisë, parandalimi i krimit dhe fuqizimi i bashkëpunimit në mes të autoritete të ndryshme në fushën e sigurisë në shkolla.

Objektivat
- ✓ Perceptimi më i mirë i sigurisë
- ✓ Shtimi i sigurisë në shkollat e mesme në Prizren
- ✓ Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me autoritetet përgjegjëse për siguri
- ✓ Aktivizimi i mekanizmave shkollore në zgjidhjen e problemeve
- ✓ Zvogëlimi i krimeve dhe frikës nga krimi
- ✓ Unifikimi i politikave të sigurisë në shkolla.

## 4

***Titulli:***
**Për një rini të shëndoshë dhe pa alkool**

Qëllimi:
Funksionimi i mekanizmave parandalues dhe ngritja e vetëdijes së rinisë për pasojat e konsumimit të alkoolit.

Objektivat:
- ✓ Ngritja e vetëdijes dhe informimi i të rinjve lidhur me pasojat që sjell konsumimi i alkoolit.
- ✓ Bashkëpunimi në mes të OJQ-ve, EVSB-ve, KK-ve dhe komunitetit afarist në zbatimin e rregulloreve të aplikueshme për kafiteritë.